



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 27 korrik 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Shaip Muja, Sabri Hamiti, Donika Kadaj- Bujupi dhe Amir Ahmeti.

Munguan: Skender Hyseni dhe Petar Miletqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi- OSBE, Lumnije Murati- ZPRK dhe Shefki Kastrati -NDI.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të datës 20 korrik 2011;
3. Miratimi i listës së ekspertëve për mbështetjen e punës së Komisionit;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës, me plotësimin e pikave të rendit të ditës si vijon:

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare dhe

5. Të ndryshme.

a) Diskutim dhe deklaram lidhur me zhvillimet e fundit në veri të Kosovës.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 20 korrik 2011;

Kryetari konstatoi se, Komisioni e miratoi procesverbalin e datës 20 korrik 2011.

3. Miratimi i listës së ekspertëve për mbështetjen e punës së Komisionit;

Albin Kurti- Tha se për mbështetjen e punës së Komisionit përmes angazhimit të ekspertëve, është e nevojshme që fillimisht Komisioni ta ketë një listë të ekspertëve.

Mbështetur në listën ekzistuese të propozuar të ekspertëve, si dhe propozimet e anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

1. Miratohet lista e ekspertëve për mbështetjen e punës së Komisionit në këtë përbërje:

Prof. dr. Zejnullah Gruda, prof. dr. Blerim Reka, Argjend Zejnaj, Adrian Çollaku, Agron Selimaj, Arton Demhasaj, Lirie Avdullahu, Basri Muja, Arben Çollaku dhe Jeton Bytyqi.

2. Lista e ekspertëve nga pika 1 e këtij Përfundimi mbetet e hapur për plotësim varësisht nga nevojat e Komisionit.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare nr. 04/L-52;

Anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me miratimin në parim të Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, para miratimit në parim nga Kuvendi dhe për formimin e grupit punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e këtij projektligji.

Pas diskutimeve dhe propozimeve kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet në parim Projektligji për marrëveshjet ndërkombëtare nr. 04/L-52.

Formohet grupi punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare në përbërje të deputetëve:

- 1. Hydajet Hyseni, referues,*
- 2. Donika Kadaj- Bujupi, anëtare,*
- 3. Skender Hyseni, anëtarë.*

5. Të ndryshme;

a) Diskutim dhe deklaram lidhur me zhvillimet e fundit në veri të Kosovës;

Lidhur me zhvillimet e fundit në veri të Kosovës diskutuan deputetët: A. Kurti, H. Hyseni, Sh. Muja, S. Hamiti dhe D. Kadaj- Bujupi.

Pas diskutimeve dhe deklarimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

D e k l a r a t ë

Komisioni për Punë të Jashtme deklaron që e mbështet Qeverinë e Republikës së Kosovës për vendosjen e integritetit të kufijve të Kosovës, sundimin e ligjit dhe zbatimin e Kushtetutës, si dhe funksionimin e doganave të Republikës së Kosovës edhe në pikat 1 e 31.

Komisioni për Punë të Jashtme e inkurajon Qeverinë e Republikës së Kosovës që gjithsesi ta vazhdojë luftimin e grupeve kriminale në veri të cilat sulmuan Policinë e Kosovës duke vrarë policin Enver Zymberi dhe duke plagosur shumë të tjerë. KPJ i shpreh ngushëllime familjes së policit të ndjerë Zymberi dhe ndan dhembjen me të afërmit, miqtë dhe kolegët e tij.

Komisioni për Punë të Jashtme i dënon sulmet kriminale të grupeve e strukturave të ndryshme ilegale në veri të vendit e të cilat në vazhdimësi po e rrezikojnë jetën e qytetarëve, po e cenojnë rendin dhe ligjin, si dhe po e dëmtojnë ekonominë e Kosovës me kontrabandën e tyre.

Komisioni për Punë të Jashtme kundërshton përzierjen dhe ndërhyrjen e Serbisë në Republikën e Kosovës dhe thekson që vetëm reciprociteti i plotë mundëson fqinjësi të mirë dhe zbatim të drejtë të marrëveshjeve rajonale, siç është ajo e CEFTA-s.

Komisioni për Punë të Jashtme i bën thirrje Bashkimit Evropian dhe faktorëve të tjerë ndërkombëtarë që t'i përkrahin dhe ndihmojnë institucionet dhe popullin e Kosovës në luftimin e informalitetit dhe kriminalitetit drejt bërjes së Kosovës sovrane, demokratike, me integritet territorial dhe sundim të ligjit për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti